

KONTRATË
PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË
“WORLD TRADE ALBANIA 2006” Sh.p.k



Sot, më datën 21.05.2006, para meje Noteres E. Hoxha, me Zyre Notoriale ne Tirane, Rr. Bulevardi B. Cesa, u paraqiten personalisht personat e poshteshenuar:

1. Arben Ismailaga, shtetas shqiptar, i biri i Xhevinit, lindur me 14.10.1960, ne Tirane, me Pasaporte nr. Z0179297, banues ne Tirane, Rr. Qemal Stafa, Nr. 377, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
2. Ardjan Takaj shtetas shqiptar, i biri i Petritit, lindur me 05.04.1963, ne Tirane, me Pasaporte nr. Z1021141, banues ne Tirane Rr. “Deshmoret e 4 Shkurtit”, Sky Tower, Kt. 10, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
3. Bardhyl Kurmaku, shtetas shqiptar, i biri i Hajdarit, lindur me 21.03.1948, ne Elbasan, me Pasaporte nr. Z1277972, banues ne Elbasan, Lagja. A.Pasha, Rr. Y. Myzyri, Nr. 17, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.

te cilet me vullnetin e tyre të lirë e plotë dhe në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar” si edhe Ligjit Nr. 7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit” kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kushteve e normave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në këtë Kontrate-Themelimi si më poshtë vijon:

Neni 1
Emertimi dhe Forma

Ortaket bien dakord te themelojne një shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e cila do te emertohet “WORLD TRADE ALBANIA 2006” Sh.p.k

Ne te gjitha aktet, dokumentat e nxjerra nga shoqeria, si dhe ne te gjitha veprimet juridike ne te cilat shoqeria hyn ne marredhenie juridike me te tretet, emertimi i saj do te shoqerohet perpara ose pas saj me fjalet “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ose inicialet “SHPK”.

Shoqeria do te jete e organizuar ne formen e një shoqerie me pergjegjesi te kufizuar qe do te thote se ortaket perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 2

Selia

Kjo Shoqëri Tregtare do të ketë selinë e saj në Tirane, Rr. “Deshmoret e 4 Shkurtit”, Sky Tower, Kt. 10.
Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Boçurimaku

Neni 3
Kapitali themeltar dhe Kuotat e Ortakeve

3.1 Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k është LEKE 100 000 (njeqind mijë Leke). Kapitali Themeltar eshte i ndare ne 100 pjesë te barabarta, ku çdo pjesë ka vleren nominale prej 1 000 (një mijë) Leke.

3.2 Kapitali themeltar eshte kontribut ne te holla i ortakeve themelues si me poshte vijon:

1. Z. Arben Ismailaga, nenshkruan dhe shlyen menjehere 26 % te te gjitha pjesave ne te cilat shprehet kapitali themeltar.
2. Z. Ardjan Takaj nenshkruan dhe shlyen menjehere 26 % te te gjitha pjesave ne te cilat shprehet kapitali themeltar.
3. Z. Bardhyl Kurmaku nenshkruan dhe shlyen menjehere 48 % te te gjitha pjesave ne te cilat shprehet kapitali themeltar.

Per rrjedhoje ortaket themelues zoterojne respektivisht:

1. Z. Arben Ismailaga zoteron 26 % te kuotave te kapitalit themeltar.
2. Z. Ardjan Takaj zoteron 26 % te kuotave te kapitalit themeltar.
3. Z. Bardhyl Kurmaku zoteron 48 % te kuotave te kapitalit themeltar.

3.3 Kapitali themeltar i Shoqërisë, përfaqëson kapitalin e shlyer nga Ortakët Themelues, i nevojshëm për veprimtarinë e Shoqërisë. Sipas kërkesës së Ligjit, kapitali themeltar eshte depozituar në një Banke që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

3.4 Kapitali Themeltar mund te ndryshoje vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme dhe ndryshim ky i cili mund të jetë rrjedhoje edhe i kontributeve në natyrë te ortakeve. Në rast se zmadhimë te kapitalit themeltar nepermjet kontributeve ne natyre te ortakeve, vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet sipas Nenit 42 të Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992.

Neni 4
Kohëzgjatja


Kohëzgjatja e veprimtarise se shoqërisë do të jetë e pacaktuar. Ajo mund te ndryshohet vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, ne perputhje dhe zbatim te legjisacionit ne fuqi dhe dispozitave te kesaj Kontrate Themelimi dhe Statutit te shoqerise.

Neni 5
Objekti i Veprimtarise

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k do të jetë IMPORT-EKSPORT i mallrave e artikujve industriale e bujqesore, kryesisht kafë, transporti i tyre e me gjere, si dhe tregimin perfundimtar i ketyre mallrave e artikujve.

Neni 6




Ardjan Takaj

Shoqëria Tregtare në marrëdhëniet me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e shoqërisë, fondet e saj dhe Ortakët përgjigjen për detyrimet e kësaj Shoqërie vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 7

Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me Vendim të Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakëve. Fitimi neto ndahet si pas pjesëve të kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori

Administrator i shoqerise zgjidhet z. Artjan Nana. Ai ka një mandat prej jo me pak se tre vjetesh dhe eshte i rinovueshem automatikisht. Per cdo ndryshim te kesaj kohezgjatje, Asambleja e Jashtezakonshme rezervon te drejten e vendosjes.

Administratori emerohet dhe shkarkohet prej Asamblese se Ortakëve, me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjesave se kapitalit themeltar.

Pervec kesaj administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Modalitetet për përbërjen dhe funksionimin e organeve të mësipërme përcaktohen nga statuti i Shoqërisë. Marredheniet juridike qe nuk pershkruhen ne Statut, udhehiqen nga Ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbyer e të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë edhe në mënyrë të pjesëshme.

Ortakët janë përgjegjës për pasojat e dëmshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 10

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar.

Shoqëria mund të shpërndahet me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakëve.


Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet konform legjisacionit shqiptar i cili rregullon mosmarrëveshjet në Shoqëritë Tregtare.

Gjkata kompetente eshte Gjkata e Shkalles se Pare - Tiranë.

Neni 12

Më të detajuara dispozitat për Shoqërinë Tregtare "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k janë përcaktuar dhe përbahen në Statutin e saj.

Neni 13

Kjo kontratë formulohet në katër kopje, nga të cilat njëra depozitohet në Zyrën e Noterisë Tiranë, njëra depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në Zyrën e Tatimeve Tiranë dhe kopja e katërt mbahet në dokumentat e Shoqërisë.

Kontrata është e vlefshme që nga momenti i nënshkrimit të saj nga Ortakët.

Tiranë më 22.05.2006

ORTAKËT

Arben Ismailaga

Ardjan Takaj

Bardhyl Kurmaku

PRACHTIVL KURMAKU

Bardhyl Kurmaku

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“WORLD TRADE ALBANIA 2006” Sh.p.k



Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “WORLD TRADE ALBANIA 2006” Sh.p.k është krijuar sipas kontratës për themelimin e saj nga Ortakët:

1. Arben Ismailaga, shtetas shqiptar, i biri i Xhevitit, lindur me 14.10.1960, ne Tirane, me Pasaporte nr. Z0179297, banues ne Tirane, Rr. Qemal Stafa, Nr. 377, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
2. Ardjan Takaj, shtetas shqiptar, i biri i Petritit, lindur me 05.04.1963, ne Tirane, me Pasaporte nr. Z1021141, banues ne Tirane Rr. “Deshmoret e 4 Shkurtit”, Sky Tower, Kt. 10, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
3. Bardhyl Kurmaku, shtetas shqiptar, i biri i Hajdarit, lindur me 21.03.1948, ne Elbasan me Pasaporte nr. Z1277972, banues ne Elbasan, Lagja. A.Pasha, Rr. Y. Myzyri, Nr. 17, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj Shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar” si edhe Ligjin Nr. 7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit”, dhe me qellim percaktimin e objektit te veprimit, kompetencat e organeve vendimmarrese, si dhe menyren e thirrjes dhe te mbajtjes se mbledhjeve te shoqerise përpilohet ky Statut si më poshtë:

KREU I PARE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ortakët pjesemarres në Kontratën e Themelimit, kanë krijuar një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria Tregtare e fiton personalitetin juridik në momentin e rregjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë si edhe me rregjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar, pranë kesaj Gjykate.

Neni 2

Ortaket Themelues kane vodosur qe emërtimi i shoqerise te jetë “WORLD TRADE ALBANIA 2006” Sh.p.k

Bardhyl Kurmaku

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k do të jetë IMPORT-EKSPORT i mallrave e artikujve industriale e bujqesore, kryesisht kafë, transporti i tyre e me gjere, si dhe tregimin perfundimtar i ketyre mallrave e artikujve.

Ne funksion te ushtrimit te kesaj veprimtarie, shoqeria nepermjet organeve te saj te administrimit mund te lidhe dhe te jete pale e cdo lloj veprimi juridik, pa kufizim, duke pasur parasysh rendesine e flexibilitetit ne ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Qellimi i ketyre kompetencave eshte sigurimi dhe dhenia e garancive tek te tretet, lidhur me vlefshmerine e marrhenieve juridike, ne te cilat ata hyjne me shoqerine "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k

Neni 4

Shoqëria, në bazë të legjislacionit shqiptar, ka të drejtë të hapë filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 5

Selia e shoqërisë tregtare "WORLD TRADE ALBANIA 2006" Sh.p.k është në Tirane, Rr. "Deshmoret e 4 Shkurtit", Sky Tower, Kt. 10.

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare është për një periudhë te pacaktuar.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është LEKE 100 000 (njeqind mijë Leke).

Kapitali Themeltar eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta, ku cdo pjese ka vlore nominale prej Leke 1 000 (nje mijë Leke).

Neni 8

Pjesemarrja e ortakeve themelues eshte si me poshte vijon:

1. Z. Arben Ismailaga, zoteron 26 % te kuotave te kapitalit themeltar.
2. Z. Ardjan Takaj, zoteron 26 % te kuotave te kapitalit themeltar.
3. Z. Bardhy Kurmaku, zoteron 48 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Neni 9

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë kontribute në shërbime.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.



Neni 10

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblese se Ortakëve, me voten e te pakten $\frac{3}{4}$ pjesë te kapitalit themeltar.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 40 të Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributave në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit 42, paragrafi i parë i Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992. Eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të Gjykatës sipas kërkesës së administratorit.

Neni 11

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Zvgëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 12

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Pjesët e kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndermjet bashkëshortëve, si edhe ndërmjet parardhëseve e pasardhësve.

Pjeset e kapitalit janë lirisht te transferueshme ndermjet vete Ortakeve te Shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetem ne qofte se asnje prej ortakeve nuk pranon te bleje pjeset e kapitalit themeltar te ortakut – shites, ne rastin e transferimit me kontrate shitje dhe ne te gjitha rastet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne rast konflikti, kompetente per zgjidhjen e tij eshte Gjykata e Shkales se Pare, Tirane.

KREU III

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 13

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori.

Administratori emerohet dhe shkarkohet prej Asamblese se Ortakëve, me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve se kapitalit themeltar.
Pervec kesaç administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjt me kerkesa te cdonjerit prej ortakeve.



Neni 14

Organ i larte Vendimmarres i shoqërisë eshte Asambleja e Ortakëve.

Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre personave të zgjedhur. Vendimet e tyre evidentohen në një rregjistër.

Neni 15

Asambleja e Ortakëve vodos për çështjet e me poshtme dhe duke mos u kufizuar vetem ne to:

1. emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujdusve.
2. miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit.
3. miratimi i llogarive vjetore.
4. ndryshimi i statutit.
5. ndryshimi i selise, emertimit.
6. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar,
7. transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët.
8. mbarimi i veprimtarisë së Shoqërisë apo likujdimi i saj.
9. shndërrimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një forme tjeter shoqërie tregtare.
10. Te vendose per marrjen e kredive dhe te autorizoje administratorin ose cdo person tjeter per nenshkrimin e cdo lloj Kontrate Kredie, Kredi me Kufi si dhe cdo lloj kontrate per forma te tjera kredie, me cdo banke apo institucion tjeter finanziar. Per kete qellim Asambleja vodos per hipotekimin, vendosjen e pengut, barres siguruese mbi cdo pasuri te paluajtshme ose te luajtshme te shoqerise.

Neni 16

Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore redaktohen nga administratori.

Asambleja e Ortakeve miraton llogaritë nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

Secili prej Ortakëve ka të drejte të marrë në çdo moment dokumentat e sipërpërmendura, për 3 vitet e fundit finanziarë. Ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtronhet detyrimit përuajtjen e sekretit.

Neni 17

Ne Asamblene e Ortakeve, vendimet merren me nje shumice prej jo me vogel se $\frac{1}{2}$ e gjitha pjeseve te kapitalit themeltar, pervec kur parashikohet ndryshe ne kete statut.

Prurur me

Neni 18

Ndryshimet ne Statutin e Shoqerise vendosen nga Asambleja e Jashtezakonshme me voten e Ortakeve qe perfaqesojne te pakten 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne kushtet e mesiperme Asambleja e Jashtezakonshme vends edhe per ceshje te tjera qe Ligji "Per shoqerite tregtare" u referohet shprehimisht. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 19

Administrator i shoqerise eshte z. Artjan Nana.

Neni 20

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave, qe nen 15 i statutit i kalon Asamblese se Ortakeve.

Administratori ka te drejte dhe eshte i autorizuar nga ortaket themelues, te kryeje te gjitha veprimet lidhur me administrimin e shoqerise.

Ne kete kuader administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie kontraktore ne emer dhe per llogari te shoqerise ku perfshihen:

- a) Ndjekja e te gjitha procedurave administrative lidhur me marrjen e licensave per ushtrim aktiviteti, marrjen e lejave nga organet kompetente si dhe kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme juridike dhe materiale me qellim realizimin e interesave te shoqerise, ne kuader te marredhenieve me organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- b) Nenshkrimin e Kontratave Individuale te Punes si dhe zgjidhjen e tyre.
- c) Nenshkrimin e Kontratave te Sipermarries, Porosise, te Shkembimit, te Furnizimit, Qirase, Premtim – Shitje, Kontratat e Shitjes.
- d) Te perfaqesoje shoqerine ne kryerjen e veprimeve bankare me llogarite bankare, qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte, duke pasur te drejte te kryeje cdo veprim me to si terheqje, depozitime, transferta etj.

Administratori gëzon të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët gjithash tu edhe përpara të gjitha organeve shtetërore, administrative e gjyqësore, të të gjitha instancave. Personat e trete, qe do te caktohen si perfaqesues te shoqerise nepermjet prokures se posacme te leshuar nga administratori do te kene te drejte te veprojne ne emer dhe per llogari te shoqerise.

Neni 21

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për çdo vit financier me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 22

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin.

Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të qeverisë.

KREU IV

MARRËDHËNIET EKONOMIKO – FINANCIARE

Neni 23

Viti finanziar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

Neni 24

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, ortakët përcaktojnë pjesën që i takon mbi fitimin, të cilin i janë zbritur shumat e lëna mënjanë përfondin rezervë të domosdoshëm (jo më pak se 1/20 e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si edhe të jenë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Ortaket bien dakord qe dividentet do te shpermdahen ne menyren e me poshtme: 20 % ne fund te cdo viti te funksionimit te shoqerise dhe 80 % ne fund te vitit te III-te (trete).

Neni 25

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe, në lekë ose në valutë të huaj. Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga ekspertët kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore përfundimtare.

Neni 26

Shoqeria Tregtare, me qëllim që t'i bëjë sa më të lehta dhe më të shpejta pagesat me të tretët, do të hapë llogari bankare në një nga Bankat që janë të njoitura nga Shteti Shqiptar, vendase ose të huaja, e cila do të administrohet nga administratori.

KAPITULLI V

PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 27

Shoqeria prishet me vendim të Asamblese se Ortakëve, me jo me pak se $\frac{3}{4}$ e pjesave te kapitalit themeltar.

Shoqeria mund të shndërohet në një nga format e përcaktuara nga ligji sipas shumices se kerkuar nga ligji per cdo rast konkret.

Neni 28

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likujdimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakëve emëron një likujdues i cili paraqet reportin e likujdimit, gjendjen e aktivit e të pasivit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimit dhe afatin e nevojshëm përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakëve vendlodhi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimit, mbi mbylljen e procesit të likujdimit të Shoqërisë.

Neni 29

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit gjatë ekzistencës së Shoqërisë, si gjatë kryerjes së veprimtarisë ashtu dhe në procesin e likujdimit, do të zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare Tiranë.

Neni 30

Ky statut është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë, njëra në Gjykatën e Shkalles se Pare Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

ORTAKET

ARBEN ISMAILAGA

Arben Ismailaga

ARDJAN TAKAJ

Ardjan Takaj

BARDHYL KURMAKU

Bardhyl Kurmaku